REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AVOKATIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Avokatit të Prokurimeve për mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë, që ushtrojnë veprimtari në fushat e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera brenda e jashtë vendit;

Konstaton se gjatë vitit 2009 Avokati i Prokurimeve:

- Ka kryer hetim administrativ të plotë të procedurave të prokurimit publik dhe të koncesioneve, bazuar në ankesat e operatorëve ekonomikë ose me nismën e vet;

- Ka rritur rolin mbështetës ndaj operatorëve ekonomikë që janë ankuar pranë institucionit, duke sjellë rritje të numrit të ankesave dhe forcim të besimit ndaj veprimtarisë së institucionit;

- Ka rritur numrin dhe cilësinë e rekomandimeve e të masave administrative të propozuara, duke kontribuar në rritjen e shkallës së zbatimit të tyre nga entet prokuruese, qendrore e vendore, si dhe të pranimit nga Agjencia e Prokurimit Publik;

- Ka kontribuar në përmirësimin e bazës ligjore e nënligjore të prokurimit të fondeve publike, duke ndihmuar në përmirësimin e administrimit të tyre;

- Ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur kapacitetet profesionale të institucionit;

- Ka zgjeruar shkallën e informimit të publikut për rolin dhe veprimtarinë e tij, duke e bërë atë më transparente e bashkëpunuese.

Kuvendi rekomandon që, për vitin 2010, Avokati i Prokurimeve të konsolidojë më tej punën për:

- Rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë së punës, për të siguruar zbatimin korrekt nga autoritetet kontraktore të procedurave ligjore e nënligjore, parandalimin e parregullsive dhe shkeljeve, si dhe mbrojtjen e interesave të kandidatëve, ofertuesve e furnizuesve;

- Përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor, për të siguruar përmirësimin e funksionimit të sistemit të prokurimit publik dhe të koncesioneve, rritjen e shkallës së auditimit të tyre, rritjen e konkurrencës së lirë, si dhe minimizimin e hapësirave për vendimmarrje abuzive;

- Rritjen e bashkëpunimit dhe të ndihmës ligjore ndaj operatorëve ekonomikë;

- Konsolidimin e strukturës së institucionit, zgjerimin e veprimtarisë trajnuese dhe ngritjen profesionale të specialistëve;

- Rritjen e bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, Kontrollin e Lartë të Shtetit, organet ekzekutive dhe Kuvendin për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni për prokurimin publik dhe për koncesionet;

- Hartimin e rregullores së institucionit, ngritjen e regjistrit publik të ankesave dhe vënien e tij në dispozicion të publikut;

- Hartimin dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit, në përputhje me Marrëveshjen e Sfidës së Mijëvjeçarit.

3 qershor 2010